



RAPORT VJETOR

I PUNËS SË PZAP-it

PËR VITIN 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

RAPORT VJETOR I PUNËS SË PZAP-it PËR VITIN 2023

*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP
Prishtinë, Janar 2024*

*Rruga "Migjeni", Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës, kati -I-, 10000 Prishtinë
info@pzap-ks.org, www.pzap-ks.org 038/211-242*

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
KORNIZA LIGJORE	8
Struktura Organizative e PZAP-it	9
Struktura organizative Sekretariatit të PZAP-it	10
Zyra e Kryesuesit të Sekretariatit të PZAP-it.....	10
Departamenti Ligjor.....	11
Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	11
Përfaqësimi gjinore dhe i komuniteteve në kuadër të PZAP	12
ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA... 13	
PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL I PZAP-IT.....	14
Takimi në Konferencën e mbajtur në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut	14
Vëzhgimi i Zgjedhjeve Vendore/Lokale në Shqipëri.....	15
Grupi Punues për Planin Strategjik të PZAP-it, për periudhën 2024-2027	17
Takimet e PZAP-it me Këshillin Gjyqësor të Kosovës	17
PUNËTORITË E PZAP-IT.....	18
Punëtorja e PZAP-it me Misionin e OSBE-së në Kosovë	19
Punëtorja e PZAP-it dhe e KGJK-së.....	19
AKTIVITETET E SEKRETARIATIT	20
Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Komunitet Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Leposaviq dhe Zveçan	23
Ankesat/Apelet e pranuar në PZAP jashtë proceseve zgjedhore.....	25
Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI69/21 datë 31.05.2023.....	26
Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve	26
Trajnimet e zyrtareve të Sekretariatit.....	28
Aktivitetet nga fusha e prokurimit	28
Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara.....	29
Bashkëpunimi i PZAP-it, me akterët e tjerë të zgjedhjeve	29

Kërkesat për Qasje në dokumente publike.....	30
Aktivitetet nga fusha e komunikimit dhe informimit.....	30
BUXHETI DHE FINANCAT.....	30
Aprovimi i buxhetit.....	30
Realizimi i buxhetit.....	32
Paga dhe shtesa	35
Mallra dhe shërbime	36
Te Hyrat e PZAP-it	39
Teknologjia e Informacionit dhe Logjistikes	41
Përkthimet.....	41
Transporti.....	42
Rekomandimet e Auditimit të pasqyrave financiare të PZAP për vitin 2022.....	44

LISTA E SHKURTESAVE

PZAP	– Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
SPZAP	– Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KQZ	– Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KGJK	– Këshilli Gjyqësor i Kosovës
OSBE	– Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
LZP	– Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL	– Ligji për Zgjedhjet Lokale
ZYRA	– Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike
SP	– Subjekti Politik
KP	– Kandidat i Pavarur
QNR	– Qendra për Numërimin e Rezultateve
SIMFK	– Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SIMBNJ/HRMIS	– Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SMVP	– Sistemi i Menaxhimit të Vijueshmërisë në Punë
SMA	– Sistemi për Menaxhimin e Ankesave
ZKA	– Zyra Kombëtare e Auditimit
AQP	– Agjencia Qendrore e Prokurimit
MPB	– Ministria e Punëve të Brendshme
DMZP	– Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
LMFPP	– Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
SNKSP	– Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik
SZHMB	– Sistemi i zhvillimit të menaxhimit të buxhetit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2023, është dokumenti bazë që paraqet apo shpalosë aktivitetin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), si organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e paraqitura, që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjin Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe rregullat zgjedhore.

Raporti vjetor pasqyron aktivitetet e PZAP-it, të realizuara nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2023, në të cilin përfshihet veprimtaria dhe të arriturat e PZAP-it, gjatë kësaj periudhe.

Ky raport është dëshmi e punës së PZAP-it, që është realizuar me përkushtim dhe profesionalizëm nga ana e anëtarëve të PZAP-it, dhe stafit të administratës së Sekretariatit, siç janë puna e panelit në vendosjen e ankesave/apelve të paraqitura nga subjektet politike, rezultatet e arritura të departamenteve dhe të njëjsteve tjera të administratës së sekretariatit, aktivitetet e prokurimit, aktivitetet lidhur me çështjet e personelit, shpenzimet buxhetore, komunikimi dhe bashkëpunimi me akterët zgjedhor, të dhëna për pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it, dhe stafit të sekretariatit në konferencat dhe në punëtoritë e organizuara.

PZAP, gjatë kësaj periudhe raportuese ka realizuar objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara me Planin e Punës për vitin 2023, e ndër aktivitete më të rëndësishme kanë qenë ato lidhur me Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, dhe Zgjedhjet e Parakohshme për anëtar të kuvendeve komunale Zveçan dhe Leposaviq, të cilat janë mbajtur më datë 23.04.2023. PZAP, për këto dy procese zgjedhore ka hartuar planin e veprimit, ka njoftuar/ konfirmuar me shkrim KQZ-në, se subjektet politike që kanë aplikuar për certifikim për këto zgjedhje kanë paguar plotësisht gjobat në lidhje me cilat do zgjedhje të mëparshme dhe se nuk kanë borxhe tjera të papaguara dhe ka njoftuar KQZ-në, më të dhënat e personave të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrje në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.

Për këtë proces zgjedhor nga subjektet politike në PZAP, janë dorëzuar vetëm dy (2) apele, një (1) para shtyrjes së zgjedhjeve dhe një (1) pas shtyrjes së zgjedhjeve, ndërsa jashtë procesit zgjedhor për këtë periudhë raportuese është pranuar një apel dhe një ankesë për të cilat PZAP, ka vendosur brenda afateve të përcaktuara ligjore.

PZAP, ka parashtuar propozim për dhënien e urdhrin përmbarimor, tek përmbaruesi privat për disa raste të cilat subjektet politike kanë dështuar ti paguajnë gjobat e shqiptuara me vendime të PZAP-it, për Zgjedhjet Lokale 2021.

Pjesëmarrje e PZAP-it, në konferencën e organizuar nga OSBE, me temën “Shkëmbimi rajonal për fuqizimin e sistemeve dhe praktikave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore”, në kuadër të projektit “Mbështetje për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim, e mbajtur në Shkup të Maqedonisë së Veriut.

PZAP-i, në përbërje të gjashtë (6) gjyqtarëve dhe dy zyrtarëve të sekretariatit, nga data 12 deri më 15 maj 2023, qëndruan për vizitë zyrtare në Tiranë, e që në kuadër të kësaj vizite kanë vizituar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në Shqipëri dhe janë takuar me Komisionerin e KQZSH-së, i cili e ka njoftuar delegacionin e PZAP-it me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për të vazhduar tutje në vëzhgimin e zgjedhjeve vendore/lokale në Shqipëri, që janë mbajtura më 14 maj 2023, të cilat ishin më të veçanta ngase po realizoheshin për herë të parë përmes votimit elektronik në bashkinë Elbasan, Kamzë dhe Vore.

Në vazhden e këtyre takimeve, një delegacion i sekretariatit të PZAP-it, i përberë nga kryesuesi dhe disa zyrtarë të sekretariatit, kanë realizuar një vizitë zyrtare në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të biseduar me zyrtaret kompetent të KSHZ-se lidhur me funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Kundërshtimeve të KSHZ-së, së Maqedonisë së Veriut dhe krahasimin e këtij sistemi me Sistemin e Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve të PZAP-it (SMAA), me qëllim të shkëmbimit të përvojave në këtë fushe dhe avancimit të SMAA-së së PZAP-it.

Me qëllim të përmbushjes së mandatit të institucionit të PZAP-it, lehtësimit të kryerjes së aktiviteteve dhe objektivave që synon institucioni ti arrijë për një periudhë katër (4) vjeçare, me mbështetjen financiare nga OSBE-ja, është mbajtur takimi i parë i grupit punues për përgatitjen e dokumentit të Planit Strategjik të PZAP-it.

Për shkak të ndryshimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Këshillin Gjyqësor të Kosovës më pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it dhe zyrtarëve të sekretariatit në mbështetje të OSBE-së, ka organizuar punëtori dy ditore (26-27 shtator 2023) në Prishtinë, më qëllim të hartimit të legjislacionit sekondar me fokus hartimin e Rregullores për përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtrësia, si dhe Rregullores për strukturën organizative të sekretariatit të PZAP-it.

Gjatë vitit 2023 PZAP, ka finalizuar disa dokumente tejet të rëndësishme. Edicionin e tretë të Buletinit me përmbledhje të vendimeve më të rëndësishme që PZAP, ka marrë ndaj subjekteve politike për tri proceset zgjedhore të organizuara në Kosovë në vitin 2019 dhe 2021.

PZAP, ka përgatitur dhe finalizuar Planin Strategjik të PZAP-it, për periudhën 2024-2027 dhe ka publikuar në Web faqen e Institucionit.

Në kuadër të zbatimit të politikës së re ligjore, Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i, ka përgatitur dhe finalizuar Rregulloren për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave.

Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Sekretariatit të KGJK-së, janë ofruar komentet për përgatitjen e Rregullosës për statusin, kushtet dhe procedurën e emërimit të panelit zgjedhore për ankesa dhe parashtrësia, e cila Rregullore është miratuar nga KGJK me datën 28.12.2023.

Përmes platformës elektronike në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), është vazhduar me menaxhimin e burimeve njerëzore, është përgatit plani individual i personelit, është bërë përditësimi i të dhënave të nëpunësve civil dhe anëtarëve të PZAP-it, në dosjet e tyre personale në mënyrë fizike dhe elektronike, si dhe është përgatitur raporti vjetor i resurseve njerëzore të PZAP-it, për vitin 2023.

Për qëllim të rritjes së transparencës institucionale me fokus informimit dhe komunikimi të rregullt me akteret zgjedhor dhe palët e interesuara, është bërë ridizajnimi dhe zhvillimi i Web faqes zyrtare të PZAP-it, si dhe është bërë avancimi i moduleve për përdorim të Sistemit për Menaxhimin e Ankesave.

PZAP-it, me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 08/L-193 për vitin 2023, i është ndarë buxhet në shumë prej 207,742€, por ky buxhet është rritur edhe për 16.292€ me vendim të Qeverisë për arsye të zbatimit të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

PZAP-i, ka realizuar (inkasuar) të hyra në vlerë prej 6,514€ nga zbatimi i vendimeve të shqiptuara me gjoba ndaj subjekteve politike nga zgjedhjet e vitit 2019 dhe vitit 2021.

Buxheti i PZAP-it për të gjitha kategoritë ekonomike gjatë vitit 2023 është shpenzuar, në shumë prej 195,766€ apo 87.38%.

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në Raportin e Auditimit të PZAP-it, për vitin financiar 2022, të datës 30.05.2023, ka konstatuar se Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2022, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

VIZIONI

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia PZAP, është dhe synon të jetë një institucion i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ, që punon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

MISIONI

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia PZAP, me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akterët lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP, është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

KORNIZA LIGJORE

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia/PZAP, në zbatim të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave të tij, bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare, për të siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, subjekteve politike, dhe aktereve tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen lidhur me kontestet zgjedhore. Vendimet e PZAP-it janë të detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrëhet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme e Kosovës vendos ndryshe.

Korniza ligjore primare bazike, por që nuk kufizohet vetëm, ngase PZAP, realizon mandatin e tij edhe përmes legjisllacionit si në vijim:

- ♦ *Ligji Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;*
- ♦ *Ligji Nr.03/L-256 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;*
- ♦ *Ligji Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës;*
- ♦ *Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili ka hyre në fuqi me date 19.07.2023;*
- ♦ *Rregulloren Nr. 01/2022 Për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave dhe Apeleve,*
- ♦ *Rregullat Zgjedhore të KQZ-së.*

Për zbatim të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i, ka përgatitur dhe finalizuar Rregulloren për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave, si dhe formularët standard që palët do të përdorin për dorëzimin e ankesave dhe formularin e konfirmimit të pranimit të ankesës.

Struktura Organizative e PZAP-it

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-L073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës emëron anëtarët e PZAP, nga radhët e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore të Kosovës dhe shërbejnë për një mandat të ripërtritshëm prej katër (4) viteve. Në bazë të këtij ligji PZAP-i, ka qenë i përberë nga 10 anëtar duke përfshirë kryesuesin e PZAP-it.

Ndërsa sipas Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili ka hyre në fuqi më datë 19.07.2023, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-së, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa anëtarët emërohen nga radha e gjykatësve të Gjykatës së Apelit dhe shërbejnë për një mandat të ripërtritshëm prej katër (4) viteve. Në bazë të këtij ligji PZAP-i, përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtar duke përfshirë kryesuesin e PZAP-it.

Me miratimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së) Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me natyrën e punës së PZAP-it, obligohet që të miraton akt të veçantë për kushtet dhe përvojën specifike të gjyqtarëve që mund të emërohen në PZAP.

Në rast se pozita e kryesuesit apo një anëtar i mbetet e zbrazët, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron një person në atë pozitë brenda tridhjetë (30) ditëve.

PZAP-i mund të mbledhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtar.

Me buxhetin e vitit 2023 të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka të lejuara/aprovuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtar të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Me dispozitat kalimtare të LZP-së Udhëheqësi aktual i Sekretariatit të PZAP-së, me automatizëm emërohet ushtrues i detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së deri në rekrutimin e kësaj pozite, e cila fillon pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës/PZAP aktualisht përbehet prej kryesuesit dhe anëtarëve si vijon:

1. Shukri Sylejmani, Kryesues i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës;
2. Adnan Konushevci, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Themelore – Prishtinë;
3. Kymete Kicaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës Themelore-Prizren;

4. Burim Ademi, anëtarë i PZAP-it/Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit – Prishtinë;
5. Hajriz Hoti, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë;
6. Franciska Zhitija-Ymeri, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit-Prishtinë;
7. Arsim Hamzaj, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë.

Anetari i PZAP-it Nikolla Petronijeviq, Gjyqtar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, për shkak se në vitin 2022 ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga KGJK-ja lidhur me dorëheqjen e paraqitur nga ana e tij, evidentohet si anëtar i PZAP-it dhe është në listën e pagave të PZAP-it, por që nuk realizon të ardhura personale që nga koha e njoftimit që PZAP-i ka pranuar nga KGJK-ja për dorëheqjen e tij. Po ashtu gjatë vitit 2023 përbërja e panelit ka pësuar ndryshime, për shkak të përfundimit të mandatit të anëtarit të PZAP-it, z. Ferki Xhaferi, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega Vushtrri.

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtar të PZAP-it përfshirë edhe kryesuesin. Aktualisht janë të emëruar dhe kanë mandat shtatë (7) anëtar aktiv të PZAP-it, përfshirë kryesuesin dhe një (1) anëtar pasiv si më lartë shënuar i cili është në dorëheqje, ndërsa katër (4) pozita të anëtarëve të PZAP-it, janë të zbrazëta, të cilat duhet të plotësohen në përputhje me nenin 115 të Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Struktura organizative e Sekretariatit të PZAP-it

Në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi ligjore që ka, PZAP-i mbështetet nga udhëheqësi i Sekretariatit dhe zyrtarë të tjerë të cilit ofrojnë përkrahje profesionale dhe teknike për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e tij të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Organizimi i brendshëm i Sekretariatit të PZAP-it, është i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP. Sipas kësaj Rregullore, struktura e sekretariatit përbehet prej dhjetë (10) zyrtarëve, përfshi kryesuesin e sekretariatit dhe dy departamenteve :

Sekretariati i PZAP-it

PZAP-ja, në ushtrimin e përgjegjësi dhe funksioneve të tij, mbështetet nga Sekretariati i cili punon në pajtim me LZP dhe i nënshtrohet rregullave të përgjegjësisë së zyrtarëve publikë të administratës së institucioneve të drejtësisë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me akt të veçantë miraton strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të Sekretariatit të PZAP-së, duke përfshirë edhe rregullimin e aspekteve të marrëdhënies së punës së zyrtarëve. Zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-së e kanë statusin e zyrtarit publik të punësuar në institucionet e drejtësisë.

Sekretariati i PZAP-it, udhëhiqet nga drejtori i saj, i cili i përgjigjet PZAP dhe ka mandat të zyrtarit të nivelit të lartë drejtues dhe emërohet në bazë të procedurave të përcaktuara në ligjin në fuqi për zyrtarët publikë dhe është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it. Zyrën e Drejtorit të sekretariatit të PZAP-it e përbejnë Drejtori i sekretariatit dhe Asistentja Ekzekutive.


Departamenti Ligjor

Ndër përgjegjësitë kryesore që ka, mbështet punën profesionale të PZAP-it dhe Sekretariatit, duke siguruar kryerjen e shërbimeve juridike, këshilluese, për të siguruar menaxhim efektiv, identifikimin e nevojave për hartimin e politikës së legjislacionit primar dhe sekondar duke siguruar respektimin e teknikave dhe standardeve, të ofroj mbështetje profesionale menaxhmentit të institucionit dhe paneleve të gjyqtareve në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, si dhe ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të duhura për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e Departamentit. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë, përfshirë Drejtorin e departamentit ligjor dhe tre (3) zyrtar të lartë ligjor, ku secili prej tyre është pjesë e njërit nga panelet e PZAP-it.

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen e burimeve materiale, ofrimin e shërbimeve administrative dhe teknike, menaxhimin e financave dhe buxhetit, Teknologjisë Informative si dhe logjistikën e PZAP-it. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë Drejtori për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Administratori i Teknologjisë Informative, Koordinatorin i Përkthimeve dhe Zyrtari i Transportit.

**ORGANOGRAMI I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA –
(PZAP)**




Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të PZAP-it

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it, deri në fund të këtij viti duke përfshirë kryesuesin është shtatë (7), prej tyre pesë (5) janë të gjinisë mashkullore ose 71% ndërsa dy (2) janë të gjinisë femërore ose 29%, kurse sa i përket përkatësisë etnike shtatë (7) janë shqiptarë ndërsa katër (4) pozita të anëtarëve të PZAP-it, janë të pa plotësuara.

Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të Sekretariatit të PZAP-it

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it, është 10 zyrtarë, prej tyre gjashtë (6) janë të gjinisë mashkullore ose 60%, ndërsa katër (4) janë të gjinisë femërore ose 40%, kurse sa i përket përkatësisë etnike nëntë (9) janë shqiptarë ose 90% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 10%. Në fund të këtij viti numri i të punësuarve në Sekretariatit e PZAP-it, është nëntë (9), për arsye se një zyrtar në bazë të kërkesës nga ana e tij dhe miratimin të te njëjtës nga menaxhmenti gjendet në pushim pa pagesë, për periudhë një vjeçare.



ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia PZAP-i, në bazë të funksioneve dhe përgjegjësisë të tij të përcaktuara me LZP, përveç vendosjes së ankesave dhe apeleve që parashtrihen gjatë procesit zgjedhor, kryen edhe aktivitetet tjera të ndryshme që nuk ndërlidhen me zgjedhje, por me funksionimin e përhershëm dhe të rregullt të institucionit.

PZAP-i, gjatë vitit 2023 ka mbajtur takime/mbledhje të rregullta në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë nxjerr vendime në përputhje me LZP-në, si dhe ligjet tjera të aplikueshme. Janë marrë vendime administrative për çështje të ndryshme që janë në mandatin e institucionit, në kuptim të menaxhimit të gjithmbarshëm të punës së PZAP dhe Sekretariatit.

Vendimet kryesore të marra nga PZAP-i

- Vendimi për miratimin e Planit të Punës së PZAP-it për vitin 2023;
- Vendimi për organizimin e punëtorisë së PZAP-it në Tiranë nga data 16-19 Mars 2023;
- Vendimi për miratimin e Raportit të Punës së PZAP-it, për vitin 2022;
- Vendimi për caktimin e anëtarëve të PZAP-it, dhe zyrtarëve të sekretariatit për të marrë pjesë në vëzhgimin e Zgjedhjeve vendore në Shqipëri që janë mbajtur më 14 maj 2023;
- Vendimi për formimin e grupit punues për përgatitjen e dokumentit të Planit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2024 – 2027;
- Vendim për emërimin e Udhëheqësit - kryesuesit aktual të Sekretariatit të PZAP-së, në pozitën e ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së;
- Vendim për miratimin e Planit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2024-2027;
- Vendim për përgatitjen dhe miratimin e Rregullores për Parashtrimin dhe vendosjen e ankesave.

PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL I PZAP-IT

Takimi në Konferencën e mbajtur në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Më datën 26 dhe 27 Prill 2023, në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut është mbajtur Konferenca me temën “Shkëmbimi rajonal për fuqizimin e sistemeve dhe praktikave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore”. Konferenca është organizuar nga zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Misioni i OSBE-së në Shkup, si pjesë e projektit “Mbështetje për Reformat Zgjedhore në Ballkanin Perëndimor” (WBFU), financuar nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim, ODIHR dhe Misioni i OSBE-së.

Qëllimi i konferencës ka qenë që të shërbejë si një platformë për të shkëmbyer njohuri dhe për të diskutuar zgjidhje për të forcuar sistemet dhe praktikatat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore në kuadër të procesit të ndjekjes së rekomandimeve zgjedhore në Ballkanin Perëndimor.

Ne konferencë diskutimet pra kryesisht janë fokusuar në modelet ekzistuese, kuadrin ligjor dhe praktikatat për dëgjimin efektiv të ankesave zgjedhore në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë çështjet e përsëritura që lidhen me kufizimet e statusit ligjor, si dhe gjykimin në kohë dhe transparent. Vëmendje e veçantë i është kushtuar transparencës së trajtimit të mosmarrëveshjeve zgjedhore nga komisionet zgjedhore dhe gjykatat dhe aksesit të mjeteve juridike në dispozicion

për mosmarrëveshjet zgjedhore. Konferenca ka shqyrtuar gjithashtu arsyet për paraqitjen e ankesave duke analizuar përvojat krahasuese në lidhje me ankesat dhe apelimet që ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve.

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues të organeve të menaxhimit zgjedhor; gjyqësori; organizatat e shoqërisë civile, duke përfshirë grupet qytetare të vëzhgimit të zgjedhjeve; dhe ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë nga Shqipëria, Kosova, Mali i zi, Maqedonia e Veriut, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, etj.

PZAP-in në këtë konferencë e ka përfaqësuar kryesuesi/U.D. Drejtori i sekretariatit të PZAP-it.

Vëzhgimi i Zgjedhjeve Vendore/Lokale në Shqipëri

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës me Planin Vjetor të Punës për vitin 2023, ndër aktivitetet e tij ka planifikuar edhe organizimin e vizitave jashtë vendit që i referohet Vëzhgimit të Zgjedhjeve Lokale apo Parlamentare, me theks të veçantë shkëmbimin e përvojave dhe nxjerrjen e mësimëve në lidhje me funksionimin dhe vendimmarrjen e organeve administrative ose gjyqësore të cilat zgjidhin kontestet zgjedhore.

Për këtë qëllim, PZAP në përfaqësim të 6 (gjashtë) gjyqtarëve dhe 2 (dy) zyrtarë të administratës së sekretariatit të PZAP-it, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore/Lokale në Shqipëri, që janë mbajtur më 14 maj 2023. Vizita e delegacionit të PZAP-it, u realizua nga data 12-15 maj 2023, pas një ftese të autoriteteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë.

Kjo vizitë ishte mjaft e rëndësishme për delegacionin e PZAP-it, nisur nga fakti se vëzhgimi i zgjedhjeve në ditën e votimit dhe pjesëmarrja në takimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të udhëhequr nga Komisioneri, ishte një mundësi e mirë për të parë nga afër ndryshimet e reja në realizimin e procesit zgjedhor si dhe mënyrën e votimit elektronik.

Në takimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Shqipërisë të mbajtur më datën 13 maj 2023, në të cilin ishin pjesëmarrës edhe shumë përfaqësues nga shtetet tjera, ishte një mundësi e mirë për delegacionin e PZAP-it, që të marrë njohuri të reja dhe të shkëmbimit të përvojave me përfaqësuesit e shtetit mikpritës dhe përfaqësuesit e shteteve respektive pjesëmarrëse në vëzhgimin e procesit zgjedhor, sidomos të mënyrës së re të përdorimit të sistemit dhe votimit elektronik në Shqipëri. Gjatë këtij prezantimi u theksua se zgjedhjet vendore/lokale në Shqipëri të 14 majit 2023, do të realizohen përmes votimi elektronik vetëm për bashkinë e Elbasanit, Kamzë dhe Vore.

Delegacioni i PZAP-it, në cilësinë e vëzhguesit, janë fokusuar për të monitoruar nga afër dy mënyrat e votimit atë elektronik dhe me formular fizik.

Fillimisht është monitoruar procesi i votimit në Bashkinë e Elbasanit, në qendrën e votimit në Shkollën e Mesme „Dhaskal Todri. Proces i votimit në këtë qendër është zhvilluar në mënyrë

elektronike për zgjedhjen e Kryetarit dhe Këshillave të Bashkësisë. Kjo mënyrë e votimit në këtë qendër zgjoi kureshtjen dhe interesimin e madhe për delegacionin e PZAP-it, si një formë e re e votimit, përmes se cilës shihej lëvizja dhe renditja e votueseve, nisur nga procesi i regjistrimit, evidentimi i votueseve, mënyra e përzgjedhjes së të preferuarave të tyre, dhe hedhja e votës përmes sistemit elektronik.

Vendvotimi i dyte ishte në Tiranë në shkollën e mesme „Fan S. Noli, i cili po zhvillohej përmes formularëve fizik. Kjo formë e votimit tanimë kishte bërë standardin e vet të zhvillimit normal të procesit, informimin e votueseve dhe administrimin e procesit nga përgjegjësit.

Takim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Një delegacion i sekretariatit të PZAP-it (SPZAP), më datën 17 Maj 2023 ka realizuar takim njëditor me përgjegjësit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), në Republikën e Maqedonisë së Veriut të mbajtur në Shkup, në të cilin takim është diskutuar për mënyrën praktike të funksionimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Kundërshtimeve të KSHZ-së së Maqedonisë së Veriut dhe krahasimi i tij me Sistemin e Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve të PZAP-it (SMAA), me qëllim të avancimit të SMAA-së së PZAP-it.

Qëllimi i vizitës së delegacionit të sekretariatit të PZAP-it, dhe takimit ka qenë avancimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave në mes të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në Republikën e Kosovës, me theks të veçantë lidhur me mënyrën e funksionimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Kundërshtimeve në KSHZ, të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për të identifikuar përparësitë e këtij sistemi në relacion me Sistemin Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve të PZAP-it.

Iniciativa për mbajtjen/realizimin e takimit ka qenë e PZAP-it, ku me aprovimin e kryesuesit të PZAP-it, kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it, ka komunikuar me autoritetet përgjegjëse të KSHZ-së së Republikës së Maqedonisë së Veriut për aranzhimin e takimit, të cilat me kënaqësi e kanë pranuar kërkesën e PZAP-it, dhe e kanë bërë të mundur që takimi me zyrtarët e të dy institucioneve të mbahet/realizohet më datën 17 Maj 2023, në Zyrat e KSHZ-së, në Shkup të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nga krahasimi i dy sistemeve të menaxhimit të rasteve është vërejtur dhe vlerësuar se të dy institucionet kanë gati nivel të njëjtë të Sistemit të Menaxhimit të Ankesave dhe Apeleve, mirëpo me rëndësi ishte se zyrtarët e dy institucioneve, diskutuan nga afër dhe shkëmbyen përvoja dhe informata me interes reciprok dhe me synimin që në të ardhmen të kemi mundësi që të dy institucionet të shkëmbejnë praktikën e mira për avancimin e Sistemeve të Menaxhimit të rasteve, lehtësimin të punës së institucionit si dhe rritjes së transparencës së institucionit, në mënyrë që

publiku dhe akteret e tjerë të zgjedhjeve dhe jo vetëm, të kenë qasje për tu informuar për zhvillimet që ndodhin në institucion lidhur me shqyrtimin e ankesave gjatë procesit zgjedhor.

Grupi Punues për Planin Strategjik të PZAP-it, për periudhën 2024-2027

Më datë 15 Qershor 2023, është zhvilluar takim pune në mes të grupit punues të PZAP-it, për hartimin e Planit Strategjik 2024-2027 dhe përfaqësuesve nga OSBE-ja, Misioni në Kosovë, në të cilin takim është prezantuar Drafti i parë i Planit Strategjik të PZAP-it, për vitin 2024-2027, ku janë vendosur objektivat strategjike dhe ato specifike për vitet 2024-2027.

Ky Plan ka marrë për bazë gjetjet nga raporti i zbatimit të planit paraparak, në bazë të këtyre të gjeturave dhe rekomandimeve të dhëna janë nxjerrë qëllimet e reja strategjike objektivat strategjike, objektivat specifike, aktivitetet strategjike dhe indikatorët e matshëm.

Objektivat strategjike janë bazuar në vizionin dhe rolin e institucionit të PZAP-it, për funksionimin e tij, në analizën SWOT, pastaj nga diskutimet dhe takimet me anëtarët dhe zyrtarët e PZAP-it, si dhe me akterët e tjerë zgjedhor.

PZAP-i, më datë 01.12.2023, ka aprovuar Planin Strategjik për periudhën 2024-2027, duke përfshirë të gjitha prioritetet dhe nevojat e institucionit në gjashtë (6) objektiva strategjike, në njëzetë e pesë (25) objektiva specifike, me 144 aktivitete, dhe 30 indikator matës të cilat do të mundësojnë arritjen e qëllimit gjatë zbatimit të tij në praktikë.

Takimet e PZAP-it me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

PZAP-i, dhe KGJK-ja, si rrjedhojë e miratimit të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe ndryshimet/risitë që ka sjellë ky ligj sa i përket statusit dhe emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa kanë mbajtur takime dhe kanë shkëmbyer informata për aktivitetet e përbashkëta lidhur me zbatimin e këtij ligji, sipas kompetencave që i kanë.

Takimi i parë në mes të këtyre dy institucioneve PZAP-it dhe KGJK-së, është organizuar nga KGJK-ja, me ftesë të Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës z. Albert Zogaj në të cilin takim, përveç kryesuesit të KGJK-së, kanë marrë pjesë Drejtori i Përgjithshëm i sekretariatit dhe Drejtoret e Departamenteve të sekretariatit të KGJK-së, ndërsa nga ana e PZAP-it, kanë marrë pjesë: Kryesuesi i PZAP-it z. Shukri Sylejmani dhe U.D i Drejtorit të sekretariatit të PZAP-it.

Në këtë takim është diskutuar dhe janë sqaruar kompetencat që kanë të bëjnë me KGJK-në, emërimi i kryesuesit dhe anëtarëve të PZAP-it, miratimi i aktit të veçantë për kushtet dhe përvojën specifike të gjyqtarëve që mund të emërohen në PZAP, plotësimi i pozitave të zbrazëta, miratimi i aktit të veçantë për strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të Sekretariatit të PZAP-it, duke përfshirë edhe aspektet e marrëdhënies së punës të zyrtareve, procedura për përzgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, e cila zhvillohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe i cili lidhur me këtë nxjerr akt të veçantë për kualifikimet e kandidatëve dhe komponentët e vlerësimit të tyre, përfshirë të gjitha aspektet e procedurës dhe administrimit të saj. Në bazë të nenit 115

paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP-së), PZAP-ja, obligohet që t'i dorëzojë Raport Vjetor Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më së largu më 1 mars të vitit pasues pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe pas shqyrtimit të tij, i njëjti publikohet.

Po ashtu edhe në bazë të paragrafit 5 të nenit 115 të LZP-së, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, obligohet që në kuadër të raportit vjetor lidhur me sistemin e drejtësisë të cilin ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 8 të nenit 108 të Kushtetutës, në një kapitull të veçantë të saj, të përmbledh edhe punën e PZAP-it, për vitin në të cilin janë mbajtur zgjedhjet. Forma, struktura dhe përmbajtja e raportit, përcaktohet paraprakisht nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Kështu në këtë takim u diskutua edhe bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave lidhur me progresin e dy Draft Rregulloreve të përgatitura nga KGJK-ja dhe PZAP-i dhe atë:

1. Procedurës për emërimin e Panelit për Ankesa dhe Parashtresa dhe,
2. Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

PUNËTORITË E PZAP-IT

Me qëllim të përmbushjes së aktiviteteve të parapara me Planin Vjetor të punës për vitin 2023, PZAP-i, ka organizuar dy punëtori në të cilat kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it, personeli i sekretariatit të PZAP-it, si dhe përfaqësuesit nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Punëtorja e parë është mbajtur nga data 16 deri më datën 19 mars 2023, në Tiranë të Republikës së Shqipërisë, në të cilën janë prezantuar dhe shqyrtuar dokumentet e rëndësishme të PZAP-it, më qëllim të finalizimit të tyre si:

- Raporti Vjetor i punës së PZAP-it, për vitin 2022,
- Identifikimi dhe rekomandimet për reformën zgjedhore në Projektligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme,
- Diskutim i disa aktiviteteve nga Plani i punës për vitin 2023 dhe Plani i veprimit për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Laposaviq dhe Zubin Potok, si dhe për Kuvendet Komunale në Komunitat Zveçan dhe Laposaviq,
- Analiza e proceseve zgjedhore,

Ndërsa punëtorja e dytë është mbajtur në Durrës nga data 19 deri me datën 22 tetor 2023, në të cilën është diskutuar:

- Draft Plani Strategjik i PZAP-i, për vitin 2024-2027.

Punëtorja e PZAP-it mbështetur nga Misioni OSBE-së në Kosovë

Në vazhden e punëtorive tjera të cilat janë organizuar në drejtim të jetësimit të ndryshimit të Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, PZAP-i, më përkrahjen dhe mbështetjen financiare të OSBE-së ka organizuar dhe mbajtur punëtorinë në Istog nga data 15 deri më datë 17 nëntor 2023, në të cilën punëtori është prezantuar dhe diskutuar Draft Rregullorja për Parashtrimin dhe Vendosijen e Ankesave.

Punëtorja e PZAP-it dhe e KGJK-së

Gjatë këtij viti për shkak të ndryshimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka organizuar një punëtori për hartimin e legjislacionit sekondar që rezulton nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, të cilën punëtori e ka mbështetur OSBE, dhe që është mbajtur nga data 26 deri me datën 27 shtator 2023, në Prishtinë.

Në punëtori kanë marrë pjesë përfaqësuesit e zyrës ligjore të sekretariatit të KGJK-së, anëtarët e PZAP-it, zyrtaret e sekretariatit, e që ky grup punues kishin në fokus draftimin e Rregullores për Përzgjedhjen dhe Emërimin e Anëtarëve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, si dhe Rregullores për Strukturën Organizative të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.

Gjatë kësaj punëtorie janë finalizuar draftet e këtyre Rregulloreve dhe janë adresuar për miratim në KGJK. Si rezultat i kësaj pune KGJK-ja, me datën 28.12.2023, ka miratuar Rregulloren për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës. Ndërsa, Rregullorja për Strukturën Organizative të Sekretariatit të PZAP-it, ende nuk është miratuar nga KGJK-ja.

Pjesëmarrja e PZAP-it në Komisionin e Kuvendit të Kosovës për reformën zgjedhore

Në kuadër të plotësim ndryshimit të legjislacionit për reformën zgjedhore në Republikën e Kosovës, janë mbajtur disa takime me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga PZAP-i, dhe përfaqësuesve të KQZ-së, Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Reformë Zgjedhore në Kosovë dhe Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, ku janë prezantuar rekomandimet e BE-së, nga çështjet si: administrimi i zgjedhjeve dhe kontestet zgjedhore, regjistrimi i votuesve, regjistrimi i kandidatëve dhe entiteteve politike, fushata zgjedhore dhe financimi, votimi, numërimi i votave dhe tabelimi i rezultateve, pjesëmarrja e grave dhe personave me aftësi të kufizuara, media etj.

Në takimet e Komisionit të Kuvendit të Kosovës për Reformë Zgjedhore në Kosovë, PZAP-in e ka përfaqësuar kryesuesi/U.D i drejtorit të sekretariatit të PZAP-it. Në takimin e këtij komisioni të mbajtur më datë 10 Shkurt 2023, ka marrë pjesë U.D i Drejtorit të sekretariatit të PZAP-it dhe një ndër pikat e rendit të ditës ka qenë edhe çështja e statusit të PZAP-it në të cilin takim pjesëmarrësit, përfaqësuesit e partive pulitke dhe akteret tjerë, kanë diskutuar dhe kanë dhënë propozimet e tyre

për statusin e PZAP-it, që të jetë ashtu siç është i rregulluar me ligjin aktual të zgjedhjeve apo me ligjin e ri të zgjedhjeve të ndryshohet statusi i tij duke e përfshirë në Sistemin Gjyqësor të Kosovës.

Lidhur me propozime për statusin e PZAP-it, që janë dhënë në takimin e lartshënuar, PZAP-i me datën 23 shkurt 2023, ka dërguar komentet dhe qëndrimet e tij, në adresë të Komisionit të Kuvendit për Reformën Zgjedhore në Kosovë, duke mbrojtur qëndrimin se me reformën zgjedhore që aktualisht po ndodhë, **PZAP-i, duhet të mbetet organ i pavarur dhe i përhershëm**, kompetent për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave dhe apeleve gjatë procesit zgjedhor dhe jo zgjedhor sepse është organ i duhur dhe i efektshëm i ankimit për çështje elektorale, ku në raste të caktuara me këtë ligj është i mundur ankimimi përfundimtar në gjykatë (Gjykatën Supreme të Kosovës). Përveç njoftimit të Komisionit të Kuvendit për Reformën Zgjedhore në Kosovë, PZAP-i me këto qëndrime dhe komente ka njoftuar dhe akterët tjerë relevant, vendor dhe ndërkombëtar në Kosovë që kanë qenë pjesë e kësaj reforme siç janë përfaqësuesit e BE-së dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

PZAP-i, në zbatim të Rekomandimeve të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së, në Kosovë, për zgjatjen e afatit për paraqitjen e parashtresave apo ankesave zgjedhore dhe vendosjen e tyre nga PZAP-i, dhe Gjykata Supreme e Kosovës, është pajtuar me rekomandimet e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së. Lidhur me këto propozime ka njoftuar me shkrim Komisionin për Reformën Zgjedhore në Kosovë, për zgjatjen e afatit për paraqitjen e parashtresave apo ankesave zgjedhore dhe vendosjen e tyre nga PZAP-i, dhe Gjykata Supreme e Kosovës dhe ka vlerësuar se jo të gjitha afatet për paraqitjen e parashtresave apo ankesave zgjedhore dhe vendosjen e tyre nga PZAP-i, dhe Gjykata Supreme e Kosovës duhet të zgjaten.

AKTIVITETET E SEKRETARIATIT

Gjatë vitit 2023, Sekretariati i PZAP-it, ka mbajtur takime të rregullta, të cilat takime i kanë parapri mbajtjes së takimeve të rregullta të Panelit. Zyrtarët e Sekretariatit kanë përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për mbajtjen e takimeve të PZAP-it, si draft agjendat e takimeve, procesverbalet e takimeve/mbledhjeve të kaluara të PZAP-it, përgatitjen e vendimeve për aprovim në takimet e mbajtura nga PZAP-i.

Në kuadër të hartimit të dokumenteve ligjore dhe strategjike, gjatë kësaj periudhe raportuese, zyrtaret e Sekretariatit, gjegjësisht zyrtarët nga Departamenti Ligjor kanë përgatitur draft Rregulloren për Përshkrimin dhe Klasifikimin e pozitave të punës dhe draft rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës. Nxjerrja e këtyre rregulloreve ka ardhur si nevojë dhe obligim për organizimin e brendshëm të institucioneve publike si dhe për përshkrimin dhe klasifikimin e atyre pozitave të punës. Departamenti Ligjor mbi bazën e analizës ligjore dhe komenteve të ofruara nga OSBE, për ndryshimet e ligjit të zgjedhjeve në Kosovë, ka ofruar komente gjatë hartimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, posaçërisht atyre që kanë pas ndërlidhje me mandatin dhe fushën e përgjegjësisë së PZAP-it. Pas aprovimit të Ligjit Nr. 08/L-

228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 19.07.2023, zyrtarët nga Departamenti Ligjor kanë analizuar ndryshimet e reja ligjore, përfshirë mandatin dhe përgjegjësitë, afatet e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave si dhe kanë evidentuar aktet nënligjore që duhet të përgatiten.

Fillimisht është punuar në përgatitjen e draft Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Rregulloren për Strukturën e re Organizative të Sekretariatit, dhe ka ofruar komentet për draft Rregulloren për Statusin, dhe Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimin e Anëtareve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa.

Gjithashtu gjatë këtij viti është përgatitur Raporti vjetor i punës së PZAP-it, për vitin 2022, finalizimi i Buletinit të PZAP-it vëllimi III, përgatitja dhe finalizimi i Planit të Punës së PZAP-it për vitin 2023, përgatitja e Planit të Punës për vitin 2024, dhe është bërë edhe përgatitja e Planit Strategjik të PZAP-it, për periudhën 2024-2027.

Pastaj janë shqyrtuar dhe diskutuar të gjitha çështjet administrative që janë në përgjegjësi të sekretariatit siç janë ato lidhur me personelin e sekretariatit, çështjet e prokurimit, çështjet e buxhetit dhe financave, çështjet e teknologjisë informative dhe logjistikës, të përkthimit të dokumenteve të PZAP-it, çështje të transportit etj.

Në përputhje me mandatin e përcaktuar me ligjet e aplikueshme, zyrtari përgjegjës i Sekretariatit të PZAP-it, ka marrë vendime për të gjitha çështjet administrative që ndërlidhën me funksionimin e PZAP-it: Në kuadër të aktiviteteve të kryera dhe dokumenteve të përgatitura nga zyrtarët e Departamentit Ligjor dhe Departamentit për Financa dhe Shërbime të përgjithshme, në nivel të përgjegjësisë janë nxjerr vendime dhe shkresa tjera nga sekretariati, ndërsa të tjerat janë dërguar për miratim në Panelin e PZAP-it.

- Përgatitja e Draft Raportit të punës së PZAP-it, për vitin 2022,
- Përgatitja e Draft Planit Vjetor të punës së PZAP-it për vitin 2023, propozim vendimi për miratimin e tij,
- Propozim vendimi për formimin e grupit punues për hartimin Planit Strategjik 2024-2027 të PZAP-it,
- Propozim vendimet për mbajtjen e punëtorisë në Tiranë nga data 16 deri me datën 19 mars 2023,
- Përgatitja e Draft Planit të veprimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave së Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Laposaviq, Zubin Potok si dhe draft Planit të veprimit për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave, Zveçan dhe Laposaviq,
- Propozim vendimet për zgjatjen e orarit të punës për zyrtarët e Sekretariatit për zgjedhjet jashtëzakonshme për kryetar të komunave të Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Laposaviq dhe Zubin Potok dhe atyre për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave, Zveçan dhe Laposaviq,

- Propozim vendimi lidhur me vëzhgimin e zgjedhjeve vendore në Republikën e Shqipërisë për anëtarët e PZAP-it dhe të zyrtarëve të Sekretariatit, që janë mbajtura me 14 maj 2023,
- Propozim vendimet lidhur me organizimin për mbajtjen e takimit rreth lamtumirës me z. Bujar Basha, ish udhëheqës i ekipit të zgjedhjeve/këshilltarin ligjor pranë OSBE Misioni në Kosovë,
- Vendimin për caktimin e detyrave shtesë për zyrtarët e Sekretariatit të SPZAP-it, për qasje në SIMFK,
- Vendimin për aprovimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të SPZAP-it, në takimin e mbajtur në Shkup të Maqedonisë të organizuar nga OSBE lidhur me shkëmbimin rajonal për fuqizimin e sistemeve dhe praktikave për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore,
- Vendimi për pagesën e mëditjes për udhëtim zyrtar në Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut për zyrtarin e transportit në sekretariatit të PZAP-it,
- Vendimi për pagesën e mëditjes për udhëtim zyrtar në Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut për zyrtarë e sekretariatit të PZAP-it, lidhur me vizitën e realizuar në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të punës të PZAP-it,
- Vendimi për mbajtjen e punëtorisë në Durrës mbajtur nga data 19 deri me datën 22 tetor 2023,
- Vendimi për mbajtjen e punëtorisë në Istog mbajtur nga data 15 deri me datën 17 nëntor 2023 të mbështetur nga OSBE, Misioni në Kosovë,
- Vendimet për formimin e Komisioneve për pranim të mallit si: aparatet për ngrohje, përkthimi dizajnimi dhe botimi i Planit Strategjik të PZAP-it dhe Buletinit të PZAP-it vëllimi III, si dhe komisionit për pranimin e shërbimit: Ridizajnimi, zhvillimi i ueb faqes dhe avancimi i sistemit për menaxhimin e ankesave,
- Vendimet për formimin e komisioneve për inventarizimin e pasurisë jo financiare, për tjetërsimin e pasurisë jo financiare, si dhe për vlerësimin e pasurisë jo financiare,
- Njoftimi i Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me rastet e ankesave dhe apeleve për të cilat ka vendosur PZAP-i, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të komunave së Mitrovicës së Veriut, Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok si dhe për zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave, Zveçan dhe Leposaviq, që kanë të bëjnë me elemente të veprës penale. PZAP-i, me këtë njoftim ka udhëzuar KQZ-në, që për këto zgjedhje nuk ka pasur material zgjedhor për vendvotimet apo qendra te votimit që janë objekt hetimi nga Prokuroria e Shtetit,
- Paralajmërimi dhe njoftimi i subjekteve politike të cilat nuk i kanë paguar gjobat e shqiptuara me vendime të PZAP-it,
- Dorëzimi tek përbaruesi privat për ekzekutimin e vendimeve të PZAP-it, lidhur me gjobat e pa paguara nga ana e subjekteve politike për proceset e zgjedhjeve të kaluara,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kërkesave Buxhetore në Ministrinë e Financave për vitet 2024-2026,

- Përgatitja dhe dorëzimi i Raportit vjetor financiar 2022, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve -Thesari i Kosovës,
- Përgatitja dhe dorëzimi në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Raportit vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm për vitin 2022
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-it) në Ministrinë e Financave për vitet 2024-2026,
- Dorëzimi i Pasqyrave Financiare të PZAP-it, për vitin 2022 në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve etj.

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Komunitet Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Leposaviq dhe Zveçan

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave në Komunitet Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, sipas vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës kanë qenë të parapara që të mbahen me 18.12.2022, si dhe zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet e Komunave Leposaviq dhe Zveçan, kanë qenë të parapara që të mbahen me 25.12.2022, mirëpo për arsye objektive ato (zgjedhjet) nuk janë mbajtur, respektivisht me vendimin Nr.79/2022 të datës 10.12.2022, zgjedhjet janë shtyrë dhe është caktuar data e re e mbajtjes së tyre më 23.04.2023.

PZAP, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme, që janë mbajtur më datën 23.04.2023, në komunitet të cekura me lartë, në përputhje me aktet e plotfuqishme ligjore dhe nënligjore ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për të kryer aktivitetet lidhur me pranimin, shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave eventuale për këto zgjedhje.

PZAP-i, si në çdo proces zgjedhor, edhe për këto zgjedhje duke u bazuar në mandatin e tij të përcaktuar me LZP dhe Rregullat Zgjedhore, vendimin e presidentes për shpalljen e zgjedhjeve, praktiket e mira nga zgjedhjet e kaluara si dhe duke marrë për bazë edhe Planin Operacional të KQZ-së, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar të komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq, në të cilin plan janë të paraqitura afatet kohore për zbatimin e të gjitha aktiviteteve zgjedhore nga KQZ-ja, ka përgatitur Planin e veprimit, në të cilin plan janë paraqitur afatet kohore për zbatimin e aktiviteteve të PZAP-it, pasi që vendimet e KQZ-së, lidhur me këto aktivitete zgjedhore ndikojnë edhe në aktivitetet operacionale të punës së PZAP-it.

Aktivitetet tjera shitesë të realizuara si vijon:

- Shkresa njoftuese/konfirmuese e PZAP-it, për KQZ-në lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike nga zgjedhjet e kaluara për tu certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje,

- Shkresa njoftuese/konfirmuese e PZAP-it, për KQZ-në më të dhënat për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ-ja.
- Shpërndarja e Formularëve të ankesave në gjuhën shqipe dhe serbe në të gjitha Qendrat e Votimit/QV, ku qytetarët kanë mundur të parashtrojnë ankesa për parregullsitë eventuale në ditën e zgjedhjeve.

Anëtarët e PZAP-it, përfshi kryesuesin dhe stafi i sekretariatit në përputhje me mandatin e tyre të përcaktuar me LZP dhe dokumentet e miratuara nga vet PZAP-i, kanë qenë në gatishtëri dhe i kanë kryer me profesionalizëm të gjitha këto aktiviteteve prej shpalljes së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, që janë mbajtur më datë 23.04.2023.

Për këtë proces zgjedhor nga subjektet politike në PZAP, janë dorëzuar vetëm dy (2) apele, një (1) para shtyrjes së zgjedhjeve dhe një (1) pas shtyrjes së zgjedhjeve.

PZAP-i, për këto dy (2) apele ka mbajtur tri (3) seanca dhe të njëjtat i ka shqyrtuar dhe vendosur brenda afatit ligjor.

Para shtyrjes së zgjedhjeve PZAP-i, ka pranuar një (1) apel, apelin Anr.1/2022 të datës 06.12.2022 të paraqitur nga një (1) subjekt politik, si palë me interes - ankuesi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1577-2022 datë 05.12.2022, për shkak të mos certifikimit të 14 kandidatëve të këtij subjekti për zgjedhjet e parakohshme për anëtarë të Kuvendit Komunal në Leposaviq.

PZAP-i, pas administrimit të shkresave të lëndës, ka vendosur që të pranoj apelin e subjektit politik- ankuesit si të bazuar, ndërsa vendimin e ankimuar të KQZ-së, ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej në rivendosje KQZ-së, dhe është urdhëruar që ta rishqyrtoj rekomandimin e Zyrës edhe për 14 kandidatët e këtij subjekti të cilët nuk ishin certifikuar nga KQZ-ja, e që janë propozuar për certifikim nga subjekti politik - ankues, dhe për të njëjtit pas vlerësimit dhe verifikimit nga Zyra si dhe plotësimit të kushteve ligjore nga neni 29 i LZP-së, duke respektuar edhe kuotën gjinore, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Pas shtyrjes së zgjedhjeve PZAP-i, ka pranuar edhe një (1) apel, apelin Anr. 01/2023 të datës 05.05.2023, të paraqitur nga një (1) subjekt politik, si palë me interes - ankuesi, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/592-2023 i datës 04.05.2023, lidhur me Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhje të Parakohshme për Kuvendin Komunal në Leposaviq. PZAP-i, e ka refuzuar si të pabazuar apelin e subjektit politik - palës ankuese dhe kishte vërtetuar vendimin e KQZ-së.

Ndaj këtij vendimi subjekti politik, si palë me interes - ankuesi, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila Gjykatë me Aktvendimin nr. AA 11/2023 të datës 10.05.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e subjektit politik - ankuesit, ndërsa vendimin e PZAP-it, Anr. 01/2023 të datës 05.05.2023 e kishte kthyer në rivendosje.

PZAP-i, pas pranimit të aktvendimit AA.nr.17/2021 të datës 10.05.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, me rastin e rivendosjes sipas ankesës së lartë përmendur nga subjekti politik – ankuesi, duke vepruar në tërësi sipas vërejtjeve të dhëna në aktvendimin e lartcekur, në procedurë të rivendosjes ka vendosur se apeli i subjektit politik - ankuesit, është i palejuar pasi që dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, konkretisht neni 122 i këtij ligji, nuk parasheh të drejtën e ankimimit të subjekteve politike pas certifikimit të rezultatit zgjedhor, sepse rezultatet certifikohen pas përfundimit të gjitha procedurave, në QNR, procedurave të ankimimit në PZAP, dhe procedurave të ankimimit në Gjykatën Supreme të Kosovës, dhe me këtë përfundon i tërë procesi zgjedhor.

Vendimet e PZAP-it, janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të tij, dhe në kopje fizike iu janë dorëzuar palëve.

Ankesat/Apelet e pranuar në PZAP jashtë proceseve zgjedhore

Bazuar në mandatin ligjor që ka, PZAP-i, gjatë vitit 2023 ka shqyrtuar dhe vendosur edhe për ankesat dhe apelet e parashtruara jashtë proceseve zgjedhore.

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.25/2023, datë 04.04.2023, paraqitur nga kryetari i këshillit të përgjithshëm të një subjekti politik në Dragash, kundër përgjigjes me Nr. Protokollit 1610-2022, të datës 30 Mars 2023 të Zyrës për Regjistrim Certifikim dhe Kontroll Financiar (Zyra) të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Me këtë apel parashtruesi ka kërkuar që të pezullohet subjekti politik, për shkak se i njëjti ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullën Zgjedhore të KQZ-së 01/2023, për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike.

PZAP-i, pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar provat që gjendeshin në shkresat e lëndës, ka hedhur si të palejuar apelin pasi që nga interpretimi i dispozitave ligjore ka rezultuar se në cilat raste mund të apelohe vendimet e KQZ-së, dhe në rastin në fjalë pra njoftimet e bëra nga Zyra, nuk janë të apeluashme përveç nëse parashihen qartë më ligj, prandaj në këtë rast njoftimi në fjalë nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelohe.

PZAP-i, gjatë vitit 2023 ka pranuar edhe ankesën Anr.57/2023 datë 23.10.2023 paraqitur nga një palë me interes ligjor kundër Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. prot. 01/1062-2023 të datës 18.10.2023 lidhur me procedurat e Kuvendit Komunal në Shtime, për dorëheqjen dhe zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Shtime ku bashkëpunëtori profesional i Kuvendit ka dërguar shkresë në KQZ, për të kërkuar zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit, duke tejkalluar kompetencat e tij zyrtare dhe ka parashtruar kërkesë për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit në mënyrë të paautorizuar dhe të kundërligjshme në kundërshtim me legjislacionit në fuqi.

PZAP-i, pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar provat që gjendeshin në shkresat e lëndës, ka hedhur si të palejuar ankesën pasi që nga interpretimi i dispozitave ligjore Ligji nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës nuk parashihet me asnjë dispozite ligjore se mund të ankimohen vendimet

e kësaj natyre të KQZ-së, konkretisht procedurat se kush e inicion procedurën e zëvendësimit, e anëtarit të Kuvendit Komunal, andaj rasti lëndor dhe procedura e zhvilluar, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së, të cilat mund të ankimohen në PZAP.

Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI69/21 datë 31.05.2023

Gjykata Kushtetuese e ka njoftuar PZAP-in, me Aktgjykimin Nr.ref.639-2/23/ të datës 31 maj 2023, sipas kërkesës të parashtruar në Gjykatë nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), e përfaqësuar me autorizim nga V.B dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK), e përfaqësuar me autorizim nga A.K në lidhje me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës (AA.nr.29/2021) i 12 Marsit 2021 me Vendimin e PZAP-it, (Anr.736/2021) të datës 07.03.2021. Gjykata Kushtetuese për këtë rast ka konstatuar dhe ka vendosur se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, dhe se nuk ka të bëjë me cenimin e të drejtës për tu zgjedhur sipas paragrafit 1 të nenit 45 (Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes) të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut.

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Nga njësia e personelit gjatë këtij viti, janë kryer aktivitetet e parapara që i përkasin kësaj njësie, respektivisht aktivitetet në fushën e burimeve njerëzore siç ishin paraparë në planin e punës së PZAP-it, për vitin 2023.

- Përditësimi i të dhënave të nëpunësve civil dhe anëtarëve të PZAP-it, në dosjet e tyre personale në mënyrë fizike dhe elektronike përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS),
- Menaxhimi i sistemeve që lidhen direkt me përgjegjësitë e zyrës së personelit, si Sistemi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore <https://hrmis.rks-gov.net/>, sistemi i Hyrje -Daljeve <http://smvp.rks-gov.net/>, dhe PAY ROLL - Sistemi i Menaxhimit të Pagave, Sistemi i APK-së për regjistrimin e zyrtareve larte dhe zyrtareve publik (DMSA),
- Përgatitja e raportit vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore deri me 31 Dhjetor 2022 përmes HRMIS,
- Planifikimi i pushimit vjetor sipas planit orientues të pushimeve për vitin 2023,
- Përgatitja e listës së zyrtarëve të lartë publik të PZAP-it, dhe zyrtareve publik sipas kërkesës nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, njoftimi i zyrtarëve të lartë publik dhe zyrtareve publik lidhur me deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë, njoftimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për pranimin e dhuratave për vitin 2022,
- Shkarkimi i listës së pagave të zyrtarëve të PZAP-it, nga sistemi i listës së pagave të Ministrisë së Financave,
- Përgatitja e kërkesave për pushimet vjetore për personelin e SPZAP-it, në mënyrë fizike dhe përmes HRMIS,

- Menaxhimi i sistemit të vijueshmërisë në punë SMVP, të zyrtarëve të sekretariatit në mënyre elektronike dhe fizike,
- Menaxhimi i formularëve të vlerësimit të performances së zyrtarëve për vitin 2022, në HRMIS, dosje fizike dhe elektronike,
- Bashkëpunimi me IKAP, për pjesëmarrjen e personelit të sekretariatit të PZAP-it, sipas ftesave dhe planit kalendarik të IKAP-it,
- Bashkëpunimi me auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ofrimi i dokumentacionit të kërkuar sa i përket fushës së burimeve njerëzore,
- Bashkëpunimi me ASHI, lidhur me sistemin SMVP,
- Bashkëpunimi me Departamentin e Thesarit, lidhur me vazhdimin e qasjes në sistemin e pagave,
- Bashkëpunimi me sektorin e listës së pagave, lidhur me formularët e listës së pagave dhe dokumente tjera për anëtarët e larguar dhe anëtarët e emëruar të PZAP-it, dhe çështje tjera të sekretariatit,
- Pjesëmarrje në trajnimin për Zyrtar të të hyrave i organizuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve,
- Bashkëpunimi me DMZP /MPB, përgatitja e kërkesave lidhur me çështjet e personelit, si procesi i klasifikimit të vendeve të punës për personelin e SPZAP-it, sipas kërkesës nga DMZP/MPB, kërkesat drejtuar DMZP-së, lidhur me korrigjimin/përshtatjen e të dhënave të punësuarit në institucionin e SPZAP-it, kërkesë për opinion në DMZP, lidhur me klasifikimin e nivelit të pagës për anëtarët e PZAP-it, kërkesë për aprovimin e grupit, klasës dhe koeficientin e pagës për stafin e Sekretariatit të PZAP-it, me Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Ligjin e Pagave në Sektorin Publik në MPB/DMZP,
- Kërkesë drejtuar komisioneve në kuadër të MFPT, për kushte specifike të tregut, kërkesë për vlerësimin e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit më rëndësi strategjike, për zyrtarin e TI,
- Vendimi për pushim pa pagesë sipas kërkesës së zyrtarit të TI,
- Regjistrimi i të dhënave të zyrtarëve të lartë të SPZAP-it, përmes sistemit të APK-së, për deklarin elektronik (DMSA), lidhur me deklarinin e pasurisë
- Përgatitja e dokumenteve, për orët shtese për muajin prill për stafin lidhur me Zgjedhjet në Komunën e Mitrovicës së Veriut, Zveqan, Leposaviq Zubin Potok.

Trajnimet e zyrtareve të Sekretariatit

Personeli i Sekretariatit të PZAP-it, gjatë vitit 2023, ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga MPB/DMZP, projekte të Bashkimit Evropian si:

- Trajnim për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës,

Trajnimet e organizuara nga IKAP dhe të mbajtura nga zyrtaret e Sekretariatit janë:

- Programi i investimeve publike (PIP) dhe Sistemi i zhvillimit dhe menaxhimit të buxhetit (BDMS),
- Përshkrimi, vlerësimi dhe klasifikimi i pozitave të punës në Shërbimin Civil.

Aktivitetet nga fusha e prokurimit

Zyrtarja përgjegjëse e prokurimit në PZAP, bazë të Planit Përfundimtar të Prokurimit, për vitin fiskal 2023, ka kryer disa aktivitete të prokurimit publik për nevoja të PZAP-it.

- o Raporti i Kontratave të nënshkruara për institucionin e PZAP-it, përmes sistemit të E-Prokurimit, për vitin fiskal 2022,
- o Përgatitja e Planit Përfundimtar të Prokurimit, për vitin fiskal 2023, përmes sistemit të E-Prokurimit, për institucionin e PZAP-it,
- o Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për shërbime të Ridizajnit dhe Avancimit të web faqës së PZAP-it,(përgatitja dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit),
- o Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për shërbime të Sigurimeve të Automjeteve të PZAP-it,(përgatitja dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit),
- o Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për shërbime Botimi i Planit Strategjik të PZAP-it, për vitin 2024-2027 dhe Buletinit të III-, të PZAP-it, (përgatitja dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit),
- o Lidhja e Kontratës për Sigurimin e Automjeteve të PZAP-it
- o Lidhja e Kontratës për Ridizajnim dhe avancim të web faqes së PZAP-it,
- o Lidhja e Kontratës për shërbime Botimi i Planit Strategjik të PZAP-it, për vitin 2024-2027 dhe Buletinit të III-, të PZAP-it
- o Kryerja e të gjitha urdhër blerjeve për të gjitha kontratat e plotfuqishme nga Operatorët Ekonomik (kontratat e lidhura nga AQP dhe PZAP-i).
- o Përgatitja e Planeve për Menaxhimin e Kontratave, të lidhura nga Agjencia Qendrore e Prokurimit-AQP, (Kontratat Furnizim me Ujë të Pijes, Furnizim me karburante dhe Furnizim me Material të ndryshëm zyrtar,)

Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara

Zyrtari përgjegjës për certifikimin e shpenzimeve financiare gjatë vitit 2023, ka bërë certifikimi i të gjitha shpenzimeve të realizuara financiare për nevojat e PZAP-it, si:

- Certifikimi i shpenzimeve të realizuara për të gjitha kontratat e lidhura me operatorët ekonomik si: (shpenzimet e telefonisë fikse, telefonisë mobile, për ujë të pijshëm, pastrimin e veturave të PZAP-it, TV kabllor dhe internet, shpenzimet për shfrytëzimin e fotokopjeve dhe printerëve me qira) etj,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për përmbarimin e vendimeve me titull ekzekutiv,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur për punëtorit e mbajtura të PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me pagesat për karburante të veturave të PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me furnizimin me aparate për ngrohje,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me udhëtimet zyrtare të zyrtarëve të sekretariatit dhe anëtarëve të PZAP-it,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me blerjet dhe furnizim me material administrativ për PZAP,
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me shtypjen e Planit Strategjik të PZAP-it 2024-2027
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur shtypjen e Buletinit të PZAP-it vëllimi III
- Certifikimi i shpenzimeve lidhur me dizajnin e ueb faqes së PZAP-it dhe Sistemit për Menaxhimin e Ankesave
- Certifikimi, mbyllja e avanseve dhe petty-cashit për shpenzimet e realizuara,
- Certifikimi i shpenzimeve të tjera të nevojshme për PZAP-in.

Bashkëpunimi i PZAP-it, me akterët e tjerë të zgjedhjeve

Ne bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të datës 30.09.2020, për Procesin Zgjedhor në mes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Policisë së Kosovës, Prokurorit të Shtetit, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Këshillit Gjyqësorë të Kosovës dhe Komisionit të Pavarur të Mediave PZAP, ka implementuar të gjitha obligimet e parapara me këtë Memorandum. Niveli i bashkëpunimit me akterët e këtij memorandumi është ngritur në veçanti pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq të caktuara më datë 23 Prill 2023.

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve nënshkruese të Memorandumit është mbajtur takimi i organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me koordinimin e aktiviteteve të gjitha institucioneve për zgjedhjet e shpallura, Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar për Kryetar të Komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq

dhe Zubin Potok, si dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendet e Komunave Zveçan dhe Leposaviq të caktuara më datë 23 Prill 2023

Temat e takimit kryesisht ka qenë lidhur me Sigurinë për zgjedhjet në Komunitat e Veriut të caktuara në Prill të vitit 2023.

Përveç këtij takimi dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it, dhe KQZ-së, ka pasur shkëmbim të informatave lidhur me ankesat e paraqitura në PZAP-it, para shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve në Komunitat e Veriut, njoftimin me vendotimet e Zgjedhjeve në Komunitat e Veriut të mbajtura me 23 Prill 2023, materialet e të cilave janë objekt hetimi penal si dhe për shumë aktivitete të tjera.

Kërkesat për Qasje në dokumente publike

PZAP-i, më datë 19 Janar 2023, ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin për Qasje në Dokumente Publike për vitin 2022, sipas kërkesës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

PZAP-i, gjatë vitit 2023, nuk ka pranuar asnjë kërkesë që ka të bëjë me Qasjen në Dokumente Publike.

Aktivitetet nga fusha e komunikimit dhe informimit

Gjatë vitit 2023, PZAP-i, nuk ka pranuar asnjë kërkesë lidhur me ndonjë informatë nga organizatat jo qeveritare, mediat elektronike apo ndonjë pale të interesuar.

BUXHETI DHE FINANCAT

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0160. PZAP-i, financohet nga Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2023, përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve. Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimi të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë përmes sistemit të Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës (SIMFK- Free Balanc) në sistemin kesh-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Aprovimi i buxhetit

Me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 08/L-193 për vitin 2023, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, i është ndare buxhet në shumë prej 207,742€.

Planifikimi buxhetit është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht të zërave duke respektuar legjislacionin financiar, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik dhe në përputhje me strukturën egzistuese të planit kontabël.

Në kuadër të këtij buxheti, planifikimi është bërë për kategori ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa,
- Mallra dhe shërbime,
- Shpenzime komunale dhe
- Pasurit jo financiare (shpenzimet kapitale)

Në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në formë tabelore:

Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjatë vitit 2023

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2023	Buxheti i ndryshuar sipas vendimit Nr.09/169	Buxheti i ndryshuar sipas vendimit Nr.01/175	Buxheti i ndryshuar në fund të vitit sipas vendimit Nr.69/2023	Buxheti Përfundimtarë 2023
Paga dhe shtesa	140,922	2,547	1,654	12,095	157,218
Mallra dhe shërbime	50,000	-	-	-	50,000
Shpenzime Komunale	7,820	-	-	-	7,820
Shpenzimet kapitale	9,000	-	-	-	9,000
Total:	207,742	2,547	1,654	12,095	224,038

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në buxhetin e vitit 2023, ka pasur ndryshime në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe Shtesa” me vendimet e Qeverisë së Kosovës me Nr.09/169 të datës 27.10.2023, në shumë prej 2,547.02€, Nr.01/175 të datës 29.11.2023, në shumë prej 1,654€ dhe Nr.69/2023 të datës 27.12.2023 në shumë prej 12,095€. Këto ndryshime janë bërë për arsye të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, për mbulimin e mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë e Pagave dhe Shtesave, PZAP ka pasur ndryshime në koeficient me Ligjin e Ri të Pagave në Sektorin Publik, dhe për atë arsye me anë të këtyre vendimeve të


Qeverisë është bërë ndryshimi i buxhetit në kategorinë paga dhe shtesa për mbulimin e mjeteve buxhetore.

Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve Buxheti fillestar i aprovuar ka qenë në shumë prej 50,000€, dhe te kjo kategori gjatë vitit nuk kemi pasur ndryshime.

Te kategoria e shpenzimeve komunale Buxhetit fillestar i aprovuar ka qenë në shumë prej 7,820€, dhe te kategoria e shpenzimeve kapitale buxheti i aprovuar ka qenë në shumë prej 9,000€ e që edhe te këto kategori të shpenzimeve gjatë vitit nuk kemi pasur ndryshime.

Duke analizuar buxhetin e aprovuar të PZAP-it, në shumë prej 224,038€ si dhe strukturën buxhetore gjatë vitit 2023, rezulton se prej tyre :

- 70.17 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe shtesa,
- 22.31 % të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 3.49 % për shpenzimet komunale ,
- 4.03 % për shpenzimet kapitale.



Realizimi i buxhetit

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2023, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv.

Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it, për vitin 2023 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket si në vijim:


Tabela e Buxhetit dhe Shpenzimeve - 2023

Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2023	Buxheti përfundimtar 2023	Buxheti i shpenzuar- 2023	Përqindja (%) e buxhetit të shpenzuar Për vitin 2023
Paga dhe shtesa	140,922	157,218	157,218	100%
Mallra dhe shërbime	50,000	50,000	34,030	68%
Shërbime Komunale	7,820	7,820	142	1,82%
Shpenzimet kapitale	9,000	9,000	4,376	48.62%
Total:	207,742	224,038	195,766	87.38%


Në kategorinë e pagave dhe shtesave gjatë vitit janë shpenzuar 100% e buxhetit total të pagave, në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është shpenzuar 68% e buxhetit, në kategorinë e shërbimeve komunale është shpenzuar 1.82% buxhetit dhe për kategorinë e shpenzimeve kapitale është shpenzuar 48.62% e buxhetit për këtë kategori.

Gjithsejtë buxheti i shpenzuar gjatë vitit 2023, është në shumë prej 195,766€ apo 87.38% e buxhetit të aprovuar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia.

Paraqitja grafike e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike



Paraqitja grafike e krahasimit të shpenzimeve të vitit 2022 me shpenzimet e vitit 2023




Nga kjo paraqitje grafike e krahasimit të shpenzimit të buxhetit të vitit 2022 me buxhetin e vitit 2023 shihet një dallim i vogël në vitin 2023 buxheti është shpenzua diku rreth 3% më shumë se në vitin 2022.

Paga dhe shtesa

Më buxhetin e aprovuar për vitin 2023, PZAP ka 20 pozita/zyrtarë të aprovuar prej të cilëve 10 anëtar të PZAP-së, dhe 10 shërbyes civil të Sekretariatit të PZAP-së.

Tek kategoria e pagave dhe shtesave Buxheti i aprovuar ka qenë 140,922€, gjatë vitit 2023 për këtë kategori kemi pasur disa ndryshime me vendime të Qeverisë. Këto ndryshime janë bërë për arsye të hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për mbulimin e mungesës së mjeteve buxhetore në kategorinë e Pagave dhe Shtesave, dhe buxheti në fund të vitit ka qenë në shumë prej 157,218€. Nga kjo kategori buxheti është shpenzuar në shumë prej 157,218€, çka do të thotë se buxheti për këtë kategori u shpenzua 100% e buxhetit të pagave.

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2023
Paga dhe shtesa	157,217
Pagat neto përmes listës se pagave për anëtarët e PZAP-it	50,641
Pagat neto përmes listës se pagave për zyrtarët SPZAP-së	80,016
Tatimi i ndalur në të ardhura personale	11,588
Kontributi pensional i punëtorit	7,486
Kontributi pensional i punëdhënësit	7,486



Mallra dhe shërbime

Tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve Buxheti i aprovuar ka qenë 50,000€. Gjatë vitit 2023 te kjo kategori nuk kemi pasur ndryshime. Nga kjo kategori buxheti është shpenzua në shumë prej 34,030€ apo 68% e buxhetit të aprovuar.

Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:


- Modulit të aprovimeve dhe
- Modulit të blerjeve-prokurimit.

Më poshtë janë të prezantuara në formë tabelore të detajuara shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2023.

Shpenzimet nga mallrat dhe shërbimet sipas kodeve ekonomike

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2023
Mallra dhe Shërbime	34,030
Mëditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit	448
Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	6,591
Akomodimi- udhëtimet zyrtar jashtë vendit	8,265
Shpenzimet tjera të udhët. zyrtare jashtë vendit	1,500
Shpenzimet për internet	558
Shërbimet tjera telefonike vala 900	6,240
Shërbime shtypje - jo marketing	3,134
Furnizimi për Zyre	1,670
Furnizim me ushqim dhe pije –jo dreka zyrt.-uji	347
Karburante për vetura	951
Regjistrimi i automjeteve	150
Sigurimi i automjeteve	897
Taks komunale për regjistrim të automjet. Zyrtar	20
Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve	682
Qiraja e pajisjeve të TI	1,002
Drekat zyrtare	1,401
Pagesat për tarifatat-vendimet gjyqësore	171

Paraqitja grafike e shpenzimeve në kategorinë mallra dhe shërbime sipas kodeve ekonomike



Shpenzimet komunale

Te kategoria e shpenzimeve komunale Buxheti i aprovuar ka qenë 7,820€. Edhe të kjo kategori gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur ndryshime.

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura në këtë kategori buxheti është shpenzua në shumë prej 142€ ose 1.82%, dhe atë për shpenzimet e telefonisë fikse, ndërsa arsyeja e mos shpenzimit të pjesës tjetër të buxhetit është se: Shpenzimet Komunale (Shpenzimet e Energjisë Elektrikë, shpenzimet e ujit dhe shpenzimet e pagesës së mbeturinave, mirëmbajtjen e objektit) të objektit në të cilin jemi të vendosur në si institucion dhe institucionet tjera që janë të vendosura në këtë objekt i kanë kaluar nën menaxhim Ministrisë përgjegjëse për mirëmbajtjen e objekteve publike e cila ministri bënë pagesën për të gjitha shpenzimet e lartcekura.


Shpenzimet kapitale

Tek kategoria e shpenzimeve kapitale buxheti i aprovuar ka qenë në shumë prej 9,000€, të kjo kategori ka qenë i planifikuar projekti për dizajnimin e webfaqes zyrtare të PZAP-it, të cilin projekt e kemi realizuar gjatë vitit 2023, shuma e buxhetit të shpenzuar për këtë projekt është 4,376€ apo 48% e buxhetit të aprovuar.

Pjesa përmbyllëse e Shpenzimeve

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe data bazës të Sekretariatit të PZAP-it, mund të përfundojmë se për vitin 2023 buxheti është shpenzuar në shumë prej **195,766€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2023.

Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuara - 2023



Të Hyrat e PZAP-it

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në bazë të nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, mund të shqiptoj gjoba ndaj një subjekti politik në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000) Euro, në rast se përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së.

PZAP-i gjatë vitit 2023, nuk ka shqiptuar asnjë gjobë ndaj subjekteve politike, mirëpo ka realizuar (inkasuar) të hyra në vlerë prej 6,514€ prej gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike më vendimet e PZAP-it, nga zgjedhjet e vitit 2021. Pranimi i të hyrave nga gjobat e shqiptuara janë bërë përmes sistemit të SIMFK, në bazë të njoftimit nga Thesari lidhur me të hyrat në llogarinë e PZAP-it.

Me realizimin e këtyre të hyrave, subjektet politike nuk kanë asnjë obligim ndaj PZAP-it.

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2023

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP	Subjekti politik	Përshkrimi i të hyrave	Pagesa e gjobës	Data e pagesës se borxhit
1	Anr.156/2019	Koalicioni "Sloboda"	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit nr. 156/2019 në Zgjedhjet e parakohshëm për Kuvendin e Kosovës 6 tetor-2019	4,000	24.04.2023
2	Anr.650/2021	Organizata Balli Kombëtar Demokrat-OBKD	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit nr. 650/2021 në Zgjedhjet Lokale -17 tetor-2021	300.00	05.05.2023
3	Anr.637/2021	Lista e Pavarur-Bekim Jashari	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit nr. 637/2021 në Zgjedhjet Lokale -17 tetor-2021, i realizuar përmes përmbaruesit privat	1,971.10	06.06.2023
4	Anr.95/2010	Mexhid Foniqi	Pagesa e gjobës në bazë të vendimit Anr.95-2010, i realizuar përmes përmbaruesit privat	243.00	20.09.2023
Total:				6,514.10	

Gjatë vitit 2023 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it, ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 6,514 €. Këto mjete të mbledhura nga gjobat e shqiptuara të PZAP-it janë derdhur në buxhetin e Kosovës.

Teknologjia e Informacionit dhe Logjistikes

Në kuadër të Teknologjisë Informative për vitin 2023 është bërë planifikimi, administrimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e TI-së (aplikacionet e Microsoft-it të ofruar nga Ministria e Punëve të Brendshme), si dhe mirëmbajtja dhe administrimi i Ueb faqes dhe Sistemit për Menaxhimin e Rasteve, domeni-it (rrjetin e brendshëm).

Në funksion të përmbushjes së detyrave që ndërlidhen me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e çështjeve nga teknologjia informative, janë zhvilluar edhe aktivitete të ndryshme sipas kërkesave të zyrtarëve. Në kuadër të aktiviteteve më kryesore Zyrtari i Teknologjisë Informative ka mirëmbajtur dhe azhurnuar në vazhdimësi Ueb faqen e PZAP-it, dhe rrjeteve sociale, ka publikuar dokumente të rëndësishme të PZAP-it si: vendimet, formularë, udhëzime, Raportin Vjetor të punës së PZAP-it, Planin Vjetor të PZAP-it dhe informacione tjera që kanë qenë të dobishme për Institucionin. Në vazhdimësi është bërë ofrimi i përkrahjes teknike në Sistemin për Menaxhimin e Rasteve dhe Teknologjisë Informative. Zyrtari i Teknologjisë Informative ka kryer edhe aktivitete tjera nga fusha e logjistikes: Është bërë regjistrimi i inventarit në sistemin E-Pasuria dhe SIMFK, ka përgatitur specifikat për furnizime sipas kërkesave të njëjësive përkatëse, furnizim me inventar për zyre, pajisje të teknologjisë informative, sigurimin e automjeteve zyrtare, dizajnimin e webfaqes zyrtare të PZAP-it, tërheqja e parave për udhëtime zyrtare jashtë vendit, zotimi i mjeteve financiare për çdo shpenzim të ndodhur si dhe punë tjera sipas kërkesave të menaxhmentit dhe zyrtarëve të PZAP-së.

Identifikimi i nevojave të PZAP-it, për softuer të licencuar për vitin 2023. Aktivitete tjera kane qenë: Inventarizimi dhe vlerësimi i asetëve të PZAP-it, përmes programit E-pasuria, në këtë lëmi kemi pasur aktivitete të vlerësimit dhe ri-vlerësimit të pajisjeve nga teknologjia informative. Duke u bazuar në Rregulloren MF – NR. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare, është bërë rivlerësimi i pasurisë së zhvlerësuar dhe atyre jo funksionale.

Koordinatori i Përkthimeve

Koordinatori i përkthimeve, ka kryer të gjitha obligimet e dala nga PZAP/SPZAP, në pajtim me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Janë përkthyer të gjitha dokumentet e nevojshme sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it si: përkthimi i Raportit Vjetor të punës të vitit 2022; Planit i Punës për vitin 2023, përkthimi i agjendave dhe procesverbaleve të takimeve të PZAP-it dhe të Sekretariatit të PZAP-it, gjitha njoftime për publikun të publikuara në web faqen zyrtare të PZAP-it si dhe dokumenteve të tjera sipas kërkesës së zyrtarëve.

Koordinatori i përkthimeve ka të caktuar edhe i ka kryer disa detyra shtese siç janë: Pranimin e mallit në depo, janë bërë të gjitha pranimet e nevojshme që duhet të kryhen rregullisht në bazë të procesit të realizimit të pagesave. Përpos këtyre aktiviteteve, në vazhdimësi janë kryer edhe

aktivitete tjera si: kontrollimi i inventarit në depo ku për ç’do fund vit bëhet regjistrimi i të gjithë inventarit dhe i materialit administrativ që janë në depo dhe inventarit që është në posedim, ngarkimi i zyrtarëve me material administrativ, ngarkimi dhe shkarkimi i depos si dhe detyra tjera sipas kërkesave të zyrtarëve.

Zyrtari i Transportit

Zyrtari i transportit gjatë vitit 2023 ka kryer të gjitha shërbimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me transportin, si: mbajtja e evidencave të qarkullimit të veturave zyrtare dhe evidentimi i ç’do kilometër të kaluar gjatë qarkullimit të automjeteve. Në vazhdimësi janë raportuar në mënyrë specifike për ç’do tre muaj edhe në formë tabelave për shpenzimet e litarëve të shpenzuara për derivate si dhe kilometrat e kaluara për veturë zyrtare të PZAP-it dhe Veturat e huazuara nga Institucionet e Republikës së Kosovës – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka në pronësi dy makina zyrtare dhe atë:

Automjetin e Tipit: Mitsubishi Outlander me Targa të Regjistrimit RKS 5Z-101-17 dhe,
Automjetin e Tipit: Ford Focus, me Targa të Regjistrimit 5Z-102-17,

Nr. 1 Tabela e pasqyrimit të shpenzimeve në KM dhe Karburante në litër për vitin 2023

Auto.	KM Jan. - Mars 2023	Litra Jan. – Mars - 2023	KM Prill – Qersh. 2023	Litra Prill – Qersh. 2023	KM Korr. - Shtat. 2023	Litra Korr. - Shtat. 2023	KM Tetor – Dhjet. 2023	Litra Tetor – Dhjet. 2023	KM Jan. - Dhjet. 2023	Litra Jan. - Dhjet. 2023
Ford	1728	109	1117	86	578	45	1186	83	4609	323
Mits ubish i	742	36	1132	109	29	0	1260	82	3163	227
Gjith sejt:	2470	145	2249	195	607	45	2446	165	7772	550

Gjatë vitit 2023 për veturën zyrtare të PZAP-it FORD, janë shpenzuar 323 litra karburante dhe 4609 kilometra (KM) të kaluara, ndërsa për veturën zyrtare MITCUBISHI, për vitin 2023 janë të shpenzuara 227 litra karburante dhe 3163 KM të kaluara.

Si përfundim shpenzimet për karburante për veturat zyrtare të PZAP-së dhe km e kaluara janë 550 litra për karburante dhe 7772 km të kaluara.

Shpenzimet e automjeteve të huazuara

PZAP, gjatë vitit 2023 më qëllim të realizimit të aktiviteteve, ka organizuar dy punëtori jashtë vendit, dhe atë në Shqipëri, një (1) në periudhën e parë të vitit 2023 dhe një (1) në periudhën e dytë të vitit 2023. Për shkak se nuk ka pasur automjete të mjaftueshme brenda institucionit ka huazuar automjetet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK).

Nga KGJK-ja kemi huazuar dy (2) automjete:

1. Automjetin e Tipit: Passat me Targa të Regjistrimit RKS 4Z-302-02,
2. Automjetin e Tipit: Skoda Yeti me Targa të Regjistrimit RKS 01-310-02.

Nga KPK kemi huazuar një (1) automjet:

Automjetin e Tipit: Peugeot me Targa të Regjistrimit 4Z-207-03.

Nr.2 Tabela e pasqyrimt të shpenzimeve në km dhe karburante të automjeteve të huazuara për vitin 2023

Auto.	KM	Litra	KM	Litra	KM	Litra	KM	Litra	KM	Litra
	Jan. - Mars 2023	Jan. – Mars - 2023	Prill – Qersh. 2023	Prill – Qersh. 2023	Korr. - Shtat. 2023	Korr. - Shtat. 2023	Tetor – Dhjet. 2023	Tetor – Dhjet. 2023	Jan. - Dhjet. 2023	Jan. - Dhjet. 2023
Passat	558	44							558	44
Skoda Yeti							728	84	728	84
Peugeot	525	48					701	54.01	1259	98.01
Gjithsejt:	1083	92					1429	138.01	2512	230.01

Siç shihet nga pasqyrimi i shpenzimeve në tabelën Nr. 2, makinat e huazuara nga KGJK-ja, KPK-ja, kanë kaluar gjithsejtë 2512 KM dhe kanë shpenzuar gjithsejtë 230.01 litra karburante dhe të njëjtat shpenzime janë paguar me buxhetin e PZAP-it dhe janë pasqyruar në pasqyrat financiare të PZAP-it për vitin 2023.

Gjithsejtë numri i KM të kaluara dhe litra të karburanteve të shpenzuara nga automjetet e PZAP-it dhe automjetet e huazuara për vitin 2023 të paraqitura në tabelën Nr. 1 dhe Tabelën Nr. 2 sipas periudhave tre mujore dhe vjetore, janë si në vijim:

Auto.	KM Jan. - Mars 2023	Litra Jan. – Mars -2023	KM Prill – Qersh. 2023	Litra Prill – Qersh. 2023	KM Korr. - Shtat. 2023	Litra Korr. - Shtat. 2023	KM Tetor – Dhjet. 2023	Litra Tetor – Dhjet. 2023	KM Jan. - Dhjet. 2023	Litra Jan. -Dhjet. 2023
Veturat e PZAP-it	2470	145	2249	195	607	45	2446	165	7772	550
Veturat e Huazuara	1083	92					1429	138	2512	230
Gjithsejtë:	3553	237	2249	195	607	45	3875	303	10284	780

Tabela e lartshënuar pasqyron se, PZAP-i gjatë vitit 2023 me automjetet zyrtare të PZAP-it dhe automjetet e huazuara për nevoja zyrtare ka kaluar gjithsejtë: **10284** KM dhe ka shpenzuar gjithsejtë: **780** litra karburante.

Përpos këtyre aktiviteteve zyrtari i transportit ka kryer edhe punë tjera si: përcjellje e vazhdueshme e veturave për servisim të rregullt dhe jo të rregullt të veturave, pastrimin e veturave, shërbimet me transport sipas kërkesave të Kryetarit, anëtarëve të Panelit si dhe zyrtarëve të SPZAP-it, shpërndarja e dokumenteve të ndryshme nëpër institucione si dhe punë të tjerë.

Rekomandimet e Auditimit të pasqyrave financiare të PZAP për vitin 2022

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), për çdo vit bënë auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. ZKA në Raportin e auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2022 të datë 02.06.2023 ka pasur një rekomandim për sistemin E-pasurija ku në edhe pse kemi bërë regjistrimin sipas blerjeve në këtë sistem por sistemi e-pasurija nuk i ka llogaritur amortizimin e disa pajisjeve sipas rregullave për regjistrim të pasurisë. Opinioni i ZKA-së në këtë raport është: Pasqyrat Vjetore Financiare të PZAP-it për vitin 2022 prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Sipas konkluzionit të ZKA-së, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të PZAP-së, kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar – PZAP-in në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

ZKA është në fazën përfundimtare të auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të PZAP-it për vitin 2023, por ende nuk e ka nxjerr/finalizuar Raportin e auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2023. Konstatimet e Raportit final të auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2023, do ti paraqesim vitin e ardhshëm në Raportin Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2024.